

Komentet e Vodafone Albania

Per Dokumentin e Konsultimit per Implementimin e Detyrimit te Sherbimit Universal

Tirane, me 30 Nentor 2012

Komentet e operatorit te komunikimeve elektronike Vodafone Albania Sh.A. mbi dokumentin per konsultim publik per implementimin e Detyrimit te Sherbimit Universal (“Dokumenti i Konsultimit”), i paraqitur per konsultim publik jane si me poshte vijon:

- 1. Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me këtë Kapitull. A ka politika, ligje, rregullore ose vendime apo normativa të tjera, kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare, në lidhje me shërbimin universal që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?**

Vodafone Albania shprehet dakord me kuadrin ligjor te prezantuar ne kete Kapitull te Dokumentit te Konsultimit.

- 2. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi këtë kapitull në përgjithësi dhe mbi këtë Seksion diskutimi në mënyrë specifike. A ka të dhëna, studime apo konkluzione të tjera në lidhje me statusin dhe zhvillimet e sektorit të cilat AKEP duhet t'i marrë parasysh në analizën e tij?**

Vodafone Albania eshte dakord me diskutimin se nje nga arsyt kryesore per renien e penetrimit te telefonise fikse dhe telefonat me pagese eshte penetrimi i larte i telefonise celulare. Ne lidhje me penetrimin e broadband, Vodafone Albania sugjeron se broadband celular duhet te perfshihet ne seksionin e Diskutimit per te analizuar se broadband celular eshte nje treg i ri ne Shqiperi, cka shpjegon “hendekun” midis penetrimit te broadband celular ne CPC-5, BE-15 dhe BE-12 nga Shqiperia. Sic diskutohet ne Kapituj te tjere te Dokumentit te Konsultimit, tregu i broadband celular ne Shqiperi nuk ka arritur nivelin e maturitetit, dhe megjitate, qe nga licenca e pare e broadband celuar e leshuar ne 2010, tregu ka patur nje zhvillim te shpjete ne krahasim me broadband fiks.

Gjithashtu, hendeku midis penetrimit te broadband fiks ne Shqiperi dhe ne BE shpjegohet jo vetem me te ardhurat e ulta kombetare, por edhe me infrastrukturen e dobet per telefonine fikse.

- 3. Ju lutemi jepni komentet tuaja për këtë Kapitull në përgjithësi dhe për këtë Seksion diskutimi në veçanti. A ka të dhëna, studime apo konkluzione të tjera lidhur me mënyrën specifike në të cilën DSHU është zbatuar në praktikë në BE dhe vendet CPS që AKEP duhet të marrë parasysh në analizën e tij?**

Vodafone Albania mbeshtet analizen e kryer ne Kapitullin 4, dhe rekomandon me tej qe perfitimet e patrupezuara te OSHU ne ofrimin e sherbimit universal te shprehen qarte, sic jane permiresimi i imazhit te markes, te pranise se gjere, avantazhet e marketingut qe rrjedhin nga akses i nje baze te gjere, cikli i jetes se klientit, etj.

- 4. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi parimet e shtruara më sipër që AKEP propozon t'i përdorë si bazë për përgatitjen e Planit Kuadër. Ju lutem komentoni nëse AKEP duhet të konsiderojë parime të tjera në analizën e tij?**

Vodafone Albania beson ne avantazhet e nje tregu konkurrues per te patur eficence nga ana ekonomike. Keto avantazhe jane pare gjate viteve te fundit me permiresimin e cilesise se rrjetit celular, uljen e theksuar te tarifave si dhe mublimin e gjere te popullsise. Prandaj, Vodafone Albania eshte dakord me parimin se mekanizmat e tregut duhet te jene menyra e preferuar per te arritur objektivat e sherbimit universal. Nderhyrjet rregullatore duhet te ndermerren/merren parasysh vetem ne rast se tregu ka arritur maturi dhe nuk ka plotesuar nevojat e klienteve.

Vodafone Albania eshte dakord/pranon se me parimin sipas te cilit nderhyrja duhet te jete ne perputhje me kushtet vendase/te vendit. Shqiperia ka nje popullsi te vogel, me perqendrim te larte ne zonat urbane, gje qe tregon se nese caktohet nje ofrues i sherbimit universal, nga kostot qe do te shkaktohen/pasojne do te perfitoje vetem nje perqindje e vogel e popullsise (0.2%). Ne vend te kesaj, AKEP mund te konsideroje mekanizma te tjere pervec Detyrimit te Sherbimit Universal per arritjen e sherbimit universal.

Pervec parimeve te percaktuara ne kete paragraf, Vodafone Albania sugjeron se parimi i Teknologjise Neutrale duhet te merret parasysh gjithashtu nga AKEP ne analizen e tij, duke perfshire telefonine celulare si zevendesues i telefonise fikse ne ato zona ku mungon rrjeti i telefonise fikse, sic parashikohet me te drejte ne disa vende.

Ne te vertete, Vodafone Albania eshte dakord/pranon se siguria ligjore dhe korrektesia procedurale duhet te merren parasysh ne pergatitjen e kuadrit rregullator. Edhe pse ky legjislacion dytesor mund te amendohet me lehtesisht se sa legjislacioni kryesor, ai duhet te reflektoje rregulla te mirepercaktuara, te pershtatura me analizen e sektorit kombetar dhe zhvillimet afat mesme per t'i ofruar lojtareve te tregut siguri ligjore.

5. Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Dinamikat e Tregut për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

Vodafone Albania eshte dakord me diskutimin mbi Dinamikat e Tregut ne lidhje me elementin e aksesit & sherbimit nga vendndodhje fikse. Megjithate duke iu referuar Aksesit & Sherbimit nga Vendndodhje Fikse, Vodafone Albania sugjeron se sherbimet e telefonise se levizshme duhet te reflektohen gjithashtu pervec sherbimeve te telefonise fikse, per shkak te penetrimit te larte te telefonise se levizhme, sic eshte theksuar ne dokument dhe mbulimit te larte te popullsise me sherbim celular ne Shqiperi.

6. Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Tarifat Sociale për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

Analiza e tarifave sociale merr parasysh vetem sherbimet e telefonise fikse. Meqenese ka nje renie te pergjithshme te tarifave ne tregun celular, tarifate e ulta celulare duhet te merren gjithashtu parasysh, ne menyre qe te jepet nje pamje gjithperfshirese e tarifave sociale te disponueshme per perdoruesit ne tregun e komunikimeve elektronike.

Sic permendet ne Dokumentin e Konsultimit, ne Shqiperi nuk ofrohen tarifa sociale ne vetvete, meqenese skema eshte ndryshuar ne nje te tille ku Qeveria e Shqiperise i ofron pagesa ne forme subvencionit per doruesve te percaktuar me aftesi te kufizuara per te blere sherbime te telefonise fikse. Ndersa per sherbimet e tjera fikse dhe celulare, duke patur parasysh nivelin e ulet te tarifave, do te duhej te perfshiheshin ne diskutimin mbi Perballueshmerine. Nje pamje me gjithperfshirese e perballueshmerise se sherbimeve celulare jepet ne pyetjen e meposhtme.

7. Ju lutemi jepni komentet tuaja në lidhje me diskutimin më sipër mbi Përballueshmërinë për shkak të lidhjes me elementin e Aksesit & Shërbimit nga Vendndodhje Fikse. A ka ndonjë aspekt tjetër që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

Vodafone Albania është dakord me analizen e Përballueshmërisë së shërbimeve fikse dhe celulare dhe njohjen e telefonisë celulare si një alternative konkurruese ndaj asaj fikse. Me uljen e konsiderueshme të çmimeve të telefonisë fikse, ofrimi i paketave të ndryshme, duke përfshirë dhe thirrje me çmim të ulët ose pa pagesë, përballueshmeria e shërbimeve të telefonisë celulare nuk duket të jetë një barriere për aksesin për grupet e popullsisë me të ardhura të ulëta.

Për të vlerësuar përballueshmërinë e tarifave celulare, Vodafone Albania sugjeron se tarifat e mënyrës kryesore/dominante të komunikimit duhet të merren parasysh për krahasimin me tarifat e telefonisë fikse. Në realitet, paketat e integruara të ofruara për planet tarifore me parapages, që janë dhe mënyra kryesore e komunikimit (>90% e tregut) përdoren nga një pjesë e madhe e bazës së klienteve me parapagim. Në Vodafone Albania, më shumë se 40% e bazës së klienteve me parapagim përdor këto lloje oferte. Për shembull, Vodafone Club që është dhe propozimi kryesor për planet me parapagesë, ofron një sërë ofertash me çmime tepër të ulëta. Një tregues i kësaj është paketa prej 1200 minutash zanore, 600 SMS & 50 MBs të dhëna për 300 Leke. Pra, në këshillojmë që ky fakt të merret në konsideratë dhe të maten çmimet celulare si të ardhur mesatare për minutë.

Përveç kësaj, familjet me të ardhura të ulëta preferojnë paketat me parapagim, duke qenë se e kanë më të lehtë të kontrollojnë shpenzimet e tyre se sa për telefoninë fikse.

Përveç tarifave të përballueshme të komunikimit, Vodafone Albania ofron një sërë aparatësh (smartphones) me çmime të arsyeshme, për të përmbushur kështu nevojat e përdoruesve të internetit që janë pjesë e grupeve të popullsisë me të ardhura të ulëta.

Me poshtë paraqiten disa aparate me çmime të arsyeshme që gjenden në treg:

- Vodafone Smart II ofrohet në dyqanet Vodafone me një çmim prej **9.000 ALL** (me TVSH) ose përafërsisht **65 Euro**. Ky smartphone ofron internet me shpejtësi të lartë nëpërmjet rrjetit 3G dhe lidhjes me internetin përmes WiFi. Vodafone i ofron abonenteve të saj me parapagim, nëse ata zgjedhin ta blejnë këtë aparat, 500MB internet pa pagesë për një muaj, dhe abonenteve të saj me kontratë, 500MB internet pa pagesë për çdo muaj, për tre muaj në vijim.
- Vodafone 555 Blue ofrohet në dyqanet Vodafone me një çmim prej **9.000 Leke** (me TVSH) ose afërsisht **65 Euro**. Abonentet e rinj që blejnë këtë smartphone përfitojnë 500MB internet pa pagesë në muaj, për 6 muaj rrjesht, ndërsa klientet ekzistues me parapagesë përfitojnë një paketë javore interneti me 200MB.

8. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi diskutimin për Broadband për shkak se është i lidhur me elementin Akses & Shërbim nga Vendndodhje Fikse të detyrimit të SHU. A ka aspekte të tjera që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij?

Vodafone Albania është dakord me pikepamjen e Komisionit Europian se tregjet konkurruese janë më të pershtatshme për zgjerimin e tregut broadband dhe se detyrimi i financimit të kostove për zgjerimin e broadband nëpërmjet detyrimit të SHU vendos një barre të rëndë jo proporcionale

vetem ne sektorin e telekomunikacionit; kjo rrezikon shtremberimin e tregjeve dhe pengimin e investimeve private ne broadband.

Per me teper, penetrimi e broadband ne Shqiperi per momentin nuk eshte ne perputhje me Rregullin 50/80 te percaktuar ne Komunikimin e Nentorit te vitit 2011 nga KE, dhe nuk eshte gati te jete ne perputhje me kete Rregull/ore deri ne vitin 2016 sipas analizes se zhvilluar ne Dokumentin e Konsultimit.

Promovimi i broadband nepermjet masave/nderhyrjes nga Qeveria duhet inkurajohet per aq sa nuk ben trajtim preferencial te disa lojtareve te tregut ne disfavor te te tjereve, duke rezultuar ne shtremberim te tregut te komunikimeve elektronike.

9. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij.

Ligji per Komunikimet Elektronike dhe nje treg konkurrues ne kete sektor bazohen ne parimin e neutralitetit te teknologjise. Vodafone Albania eshte dakord me analizen e paraqitur ne kete paragraf. Ne rast se AKEP do te mbante parasysh kriteret e teknologjise "tradicionale" fikse me kabell per caktimin e OSHU, duke patur ne konsiderate penetrimin relativisht te ulet te telefonise fikse ne Shqiperi, kjo do te kushtonte me shume duke qene se do te nevojiteshin burime te konsiderueshme per te ndertuar rrjetin fiks, per te mbajtur dhe zgjeruar penetrimin e rrjetit fiks.

Prandaj, Vodafone Albania eshte dakord me Opsionin 2 dhe sugjeron se pikepamja me e pershtatshme eshte te merret parasysh kriteri i teknologjise neutrale per aksesin nga vendndodhje fikse, qe do te perfshinte jo vetem sherbime fikse, po edhe rrjetet celulare per te permbushur kriteret per kete element te detyrimit te SHU. Pra, nje kombinim i sherbimeve te teknologjise fikse nepermjet mbulimit te Albtelecom, Operatoreve te tjere Alternative dhe mbulimin me rrjet te telefonise celulare ne nivelin e 99.8% do te thote se ky element eshte afer te qenit i disponueshem ne menyre universale ne Shqiperi dhe se tregu ploteson ne menyre te arsyeshme nevojat e perdoruesve fundore sa i takon disponueshmerise, pa qene nevoja per caktimin e ketij elementi te SHU.

10. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij.

Mbulimi i territorit nga Vodafone Albania eshte ne nivelin 93% dhe mbulimi i popullsise eshte ne nivelin 99.8%. Per permiresimin e mbulimit operatoret e telefonise celulare investojne dhe punojne ne menyre te vazhdueshme per te permiresuar mbulimin me rrjet dhe cilesine e tyre.

Duke qene se Vodafone Albania rekomandoi adoptimin e Opsionit 2 ne lidhje me kriterin e Teknologjise per caktimin, per pjesen e mbetur prej 0.2% te popullsise qe gjendet ne nje numer te kufizuar fshatrash/komunash, ne mbeshtesim idene se nje proces projekt pas projekti do te ishte me i pershtatshem per zonat e pambuluara. Per keto zona te largeta dhe te pambuluara, Vodafone Albania sugjeron se nje investim i perbashket ndermjet operatoreve celulare apo perdorimi i perbashket i infrastruktures do te ishte me i pershtatshem per te arritur nivelin 100% te mbulimit te territorit, pa qene nevoja per te caktuar nje OSHU.

Ne rast se sugjerimi si me siper nuk do te pranohej nga AKEP, Opsioni 3 do te ishte me i pershtatshem se sa Opsioni 4. Ne lidhje me Opsionin 4, Vodafone Albania mendon se do te ishte anti konkurruese qe nje operator i cili do te caktohej si OSHU do te kishte te drejten te kerkonte

kompensim, ndersa operatore te tjere bejne edhe ata investime me kosto te larta per t'i sherbyer ketyre zonave te largeta. Prandaj, e kundershtojme fuqimisht kete zgjidhje.

11. Ju lutem jepni komentet tuaja mbi analizën dhe opsionet e diskutuara më sipër. Ju lutem rendisni këto opsione nga ai më i përshtatshmi në atë më pak të përshtatshmin për Shqipërinë. Ju lutemi përshkruani opsione të tjera (ose variacione të opsioneve të përshkruara më sipër) që AKEP duhet të marrë në konsideratë në analizën e tij.

Sic e permendem me siper ne Pyetjen 6 dhe 7, ulja e konsiderueshme e tarifave te sherbimeve te telefonise celulare i ka bere keto sherbime te perballueshme edhe per familjet me te ardhura te uleta. Kjo vertetohet nga rritja e mbulimit te popullsisë ne sherbimet e telefonise celulare (99.8% e popullsisë). Ne kete kontekst, Vodafone Albania mendon se AKEP duhet te zgjedhe Opsionin 5, duke qene se mbulimi i gjere i popullsisë me sherbime telefonie tregon se tregu i ploteson nevojat e perdoruesit fundor. Per me teper, Vodafone Albania mbeshtet pikepamjen e AKEP se dinamikat e tregut ne Shqiperi jane te tilla qe shume perdorues do te perzgjidhnin paketa celulare me parapagim si nje alternative konkurruese ndaj tarifave sociale si element i sherbimit universal.

Me nje penetrim celular te gjere ne Shqiperi, do te ishte joeficiente te caktohej nje OSHU per ofrimin e tarifave sociale te sherbimit universal per familje e percaktuara me te ardhura te uleta, qe gjithesesi mund te perballoje tarifat e uleta te ofruara nga operatoret celulare permes paketave si Vodafone Club dhe paketave te tjera.

12. Ju lutem jepni komente në lidhje me çështjen nëse të caktohet broadband si një element i detyrueshëm i SHU në Shqipëri ose kjo të mos bëhet dhe të monitorohet situatë dhe të përdoren politika të tjera për të promovuar broadband, përfshirë ato të parashtruara në Draft Planin Broadband. Ju lutemi jepni çdo koment shtesë mbi këtë çështje.

Vodafone Albania eshte pergjithesisht dakord me analizen e pershkruar ne kete paragraf/seksion. Duke marre parasysh qendrimin e Komisionit European mbi **qellimin e Detyrimit te SHU** qe ofron *“nje rrjet te sigurte te sherbimit universal per ata burimet financiare te te cileve apo pozicioni gjeografik i te cileve nuk i lejojne te kene akses ne sherbimet baze qe jane **te disponueshme per t'u perdorur nga shumica e qytetareve** dhe qe konsiderohen kryesore per pjesemarrjen ne shoqeri”*, Vodafone Albania vlereson se qellimi i detyrimi SHU perjashton automatikisht per momentin sherbimet broadband si elemente te sherbimit universal.

Ne fakt, sherbimet broadband nuk jane momentalisht te perfshira si element i detyrueshem i Sherbimit Universal ne Direktiven e Sherbimit Universal ose ne Ligjin 9918/2008. **Ka arsye te forta pse detyrimi i SHU nuk duhet te zbatohet edhe per broadband ne Shqiperi.** Se pari, broadband ne Shqiperi eshte prezantuar se fundmi, dhe eshte shume heret per te thene se tregu nuk eshte ne gjendje te plotesoje nevojat e perdoruesit. Tregu sa i takon sherbimeve broadband eshte ende ne zhvillim dhe ne rritje te shpejte. Qe nga rritja e nivelit te penetrimit te 3G e deri me tani, ka me shume gjasa qe te mos jete e nevojshme te imponohen/vendosen sherbime broadband ne kuader te sherbimeve universale.

Aktualisht, rregulli 50/80 i vendosur nga Komisioni European per te inkurajuar Shtetet Anetare te marrin parasysh perfshirjen e broadband si element i sherbimit universal ende nuk zbatohet nga

tregu Shqipatar. Sipas Planit Kombetar per Broadband, ne fund te vitit 2011, broadband ne Shqiperi ka arritur te penetroje ne 19.05% te familjeve, ne krahasim me 60.80% ne BE 27. I njejti rregull eshte adoptuar ne ndryshimin e fundit te Ligjit 9918/2008, qe do te thote sic parashikohet dhe ne Dokumentin e Konsultimit "teknologjite mbizoteruese te perdorura nga shumica e abonenteve".

Me Internetin broadband ne fazat e tij te para, imponimi i sherbimit universal do te ishte joproduktiv dhe do te rezultonte ne shtremberimin e konkurrences ne treg, duke favorizuar ofruesin (operatorin e telefonise fikse) dhe duke penguar operatoret celulare qe sapo kane hyre ne tregun e broadband me dhenien e licenses se pare 3G ne vitin 2010.

Sic u shpjegua ne pike e pare me lart, penetrimi i telefonise fikse ne Shqiperi eshte shume i ulet, pra shtrirja e broadband nepermjet operatorit te telefonise fikse do te rezultonte ne kosto joproportionale, ne krahasim me perfitimet qe do te rezultonin nga tregu i lire, lejimi i operatoreve per te plotesuar nevojat e tregut, si eshte vepruar dhe per GSM.

Ato pak vende te BE qe kane perfshire broadband ne elementet e sherbimit universal kane nje penetrim te broadband qe eshte dy ose tre here me i larte se sa ne Shqiperi. Edhe ne keto vende, perfshirja e broadband ne detyrimin e SHU eshte vendosur se fundmi (ne vitin 2011 dhe 2012).

Pra, masa te tjera mund ta suportojne zhvillimin e tregjeve broadband duke perfshire aksesin ne spektrin me frekuence me te ulet, duke lejuar perdorimin e perbashket te rrjetit, duke promovuar konkurrence efektive si dhe fonde publike te dedikuara per te mbeshtetur zgjerimin e mbulimit te rrjetit.

Ne momentin qe sherbimet broadband do te perdoren nga shumica ne Shqiperi, AKEP dhe Qeveria Shqiptare mund te bejne nje tjetër vleresim per t'i zgjeruar keto sherbime dhe per pakicen e perjashtuar.

Prandaj, Vodafone Albania sugjeron se AKEP duhet te marre parasysh Opsionin 8, te monitoroje situaten por te mos e caktojë broadband si nje element te detyrueshem per detyrimin e SHU per momentin.

Qeveria, per cdo nderhyrje qe ka per qellim zgjerimin e disponueshmerise dhe perballueshmerise se broadband ne Shqiperi duhet te mbaje parasysh ne cdo rast ruajtjen e nje tregu konkurrues dhe te jete e kujdesshme ne menyre te tille qe cdo nderhyrje nga shteti te mos perbeje trajtim preferencial ndaj nje operatorit ne disfavor te nje tjetri duke shtremberuar konkurrencen ne treg.

- 13. Ju lutemi jepni komentet tuaja për çdo proces tenderi publik për caktimin e një OSHU për të zbatuar këtë element të detyrimeve të SHU. Në veçanti, ju lutem komentoni mbi llojet e termave dhe kushteve të tilla që OSHU të mos ketë nevojë apo kërkojë asnjë financim të jashtëm. Më tej, ju lutem jepni komentet tuaja mbi periudhën e kohëzgjatjes së caktimit të OSHU.**

Vodafone Albania mendon se mundesia e pare per ofrimin e aksesit dhe sherbimit nga nje vendndodhje fikse duhet t'i jepet operatoreve, dhe jo t'i caktohet nje OSHU. Sidoqofte, ne rast se AKEP nuk do te ndiqte sugjerimin tone, Vodafone Albania mbeshtet procesin e tenderit publik, si nje proces i udhehequr konkurrenca ndermjet lojtareve ne treg.

Nga eksperiencia ne vendet e tjera, financimi i jashtem rrallehere kerkohet nga OSHU, pasi autoritetet rregullatore kane vleresuar se perfitimet qe OSHU arrin permes ofrimit te sherbimeve universale i tejkalojne kostot qe OSHU ka per sherbimet, ose qe keto kosto nuk perbejne nje barre te padrejte ndaj OSHU.

Sidoqofte, duke qene se ne Shqiperi nuk ka eksperience per zbatimin e detyrimeve te sherbimit universal, nuk eshte e qarte se cilat do te jene nxitet ekonomike te operatoreve per te marre pjese ne procesin e tenderit. Ka gjasa qe operatoret nuk do te marrin riskun per te ndermarre detyrimet e sherbimit universal pa patur sigurine se keto kosto nuk do t'i vene ne pozite te disfavorshme.

Prandaj, Vodafone Albania eshte e mendimit se financimi i jashtem permes sherbimeve universale duhet te gjenerohet vetem nese vendoset se kostot neto per ofrimin e sherbimeve universale perbejne nje barre konkurruese per OSHU.

Duke qene se plani kuader do te pergatitet nga AKEP per nje periudhe prej tre vitesh, caktimi i OSHU duhet te ofrohet per te njejten kohezgjatje dhe te rivleresohet pas kesaj periudhe.

- 14. Ju lutemi jepni opinionet tuaja në lidhje me kriteret e vendimit në rastin kur një tender dështon dhe AKEP duhet të vendosë midis përfundimit të procesit të caktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një proces të tenderit të jetë i suksesshëm, apo ecjes përpara me një proces të emërimit.**

Duke marre parasysh mundesine per ta realizuar kete element te detyrimit te SHU nepermjet operatoreve te tregut, Vodafone Albania eshte e mendimit se nese tenderi deshton, AKEP duhet te vendose te perfundoje (pezulloje) procesin e caktimit derisa kushtet te jene me te favorshme per nje tender te suksesshem, ne vend qe te procedoje me procesin e nominimit.

- 15. Ju lutemi jepni opinionet tuaja në lidhje me kriteret e përfshira më sipër që AKEP mund të marrë parasysh për të vendosur se cili operator ose cilët operatorë janë të vendosur më mirë për tu caktuar si OSHU për të siguruar elementin në fjalë të detyrimit të SHU. A ka kritere të tjera që AKEP duhet të marrë parasysh?**

Vodafone Albania eshte dakord me kriteret teknike te parashikuara ne kete seksion. Ne lidhje me kostot neto/shuma e kompensimit financiar te kerkuar per te permbushur detyrimin e SHU, keto kosto duhet te llogariten ne fund te vitit financiar dhe jo paraprakisht, pasi mund te ndodhe qe perfitimet e patrupezuara te mbulojne kostot e OSHU ne ofrimin e sherbimeve universale.

Per kete arsye, sugjerojme qe ky kriter te hiqet nga kriteret e perzgjedhjes per caktim.

- 16. Ju lutem jepni opinionet tuaja në lidhje me analizën dhe opsionet e përshkruara më sipër. Ju lutem rendisni opsionet nga më i përshtatshmi tek më pak i përshtatshmi për Shqipërinë. Ju lutem përshkruani opsione të tjera (apo variante të opsioneve të përshkruara më sipër) të cilat AKEP duhet t'i marrë parasysh në analizën e tij.**

Vodafone Albania vlereson se as ky element i shërbimit universal në lidhje me numërorin dhe shërbimin e kërkimit në numëror nuk kërkohet nga nevojat e shoqërisë shqiptare. Madje me rritjen e ndergjegjësimin të individëve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatesisë, individët konsiderojnë se numri i tyre i telefonit është personal dhe nuk janë të gatshëm ta zbulojnë atë.

Vodafone Albania ka përfshirë në formën e regjistrimit të pajtimtareve me kontratë opsionin për të dhënë pëlqimin të përfshihen në numërorin telefonik, por asnjë pajtimtar nuk e ka zgjedhur këtë opsion. Ndërsa për pajtimtarët me kartë të parapaguar, forma e regjistrimit është miratuar nga AKEP dhe ky opsion nuk është përfshirë.

Për sa i përket numrave të kontaktit të bizneseve, kjo nevojë është plotësuar nga tregu, meqenëse ka disa numërore në internet duke përfshirë informacionin për biznese, restorante, administratën, shërbime shëndetësore etj., siç është faqja fleteteverdha.com. Nevoja për këto numërore telefonike nuk është manifestuar, pasi një informacion i gjërë mund të gjendet në internet.

Sa me sipër, Vodafone Albania sugjeron se AKEP duhet të ndëje Opsionin 10, të monitorojë situatën, të paraqesë masa rregullatore shtesë dhe rivlerësojë elementin e caktimit të shërbimit të kërkimit në numëror dhe numërorit pas datës 31 dhjetor 2015.

17. Ju lutem jepni komentet tuaja lidhur me reformat rregullatore të diskutuara më lart që mund të implementohen për të lehtësuar apo përshpejtuar hyrjen në treg të elementit Numeratori/Shërbimi i Kërkimit në Numëror si pjesë e detyrimit të SHU. A ka masa të tjera rregullatore që AKEP duhet të marrë në konsideratë?

AKEP mund të konsiderojë masa të ndryshme për të lehtësuar realizimin e shërbimeve të kërkimit në numëror. Masa e parë, siç parashikohet edhe në Dokumentin e Konsultimit, do të ishte të përfshihet opsioni për të pranuar përfshirjen në numërorin telefonik dhe në shërbimet e kërkimit në numëror për pajtimtarët me kartë të parapaguar.

AKEP duhet të marrë masa të inkurajojë bashkëpunimin midis operatorëve për të ndarë informacionin e pajtimtareve të tyre që kanë dhënë pëlqimin për këtë shërbim, në mënyrë që të jepen në mënyrë efektive shërbimet e kërkimit në numëror, për pajtimtarët e të gjithë operatorëve. Gjithashtu, përdorimi i këtyre të dhënave duhet të kufizohet në shërbimin e kërkimit në numëror dhe të mos përdoret për asnjë qëllim tjetër.

18. Ju lutem jepni komentet tuaja në lidhje me çdo proces tenderi publik për caktimin e Ofruesit të Shërbimit Universal që do të implementojë këtë element të detyrimit të SHU. Në mënyrë të veçantë, ju lutem komentoni mbi llojet e termave dhe kushteve të tilla që Ofruesi i Shërbimit Universal të mos ketë nevojë apo kërkojë ndonjë financim të jashtëm. Ju lutem jepni komentet tuaja në lidhje me kohëzgjatjen e periudhës së caktimit të OSHU.

Vodafone Albania është e mendimit se mundësia e parë për ofrimin e shërbimit të kërkimit në numëror i duhet dhënë operatorëve dhe të mos i caktohet një OSHU. Megjithatë, në rast se AKEP nuk do të ndiqte sugjerimin tonë, Vodafone Albania mbështet procesin e një tenderi publik, si një proces i drejtuar nga konkurrueshmëria ndërmjet paleve të interesuara.

Nga eksperiencia ne vendet e tjera, financimi i jashtem kerkohej rrallehere nga OSHU, pasi autoritetet rregullatore kane vleresuar se perfitimet qe realizohen nga OSHU nepermjet ofrimit te sherbimit universal i tejkalon kostot qe OSHU ka per keto sherbime, ose qe keto kosto nuk perbejne nje barre te padrejte per OSHU.

Megjithate, meqenese ne Shqiperi nuk ka eksperience per implementimin e detyrimit te sherbimit universal, nuk eshte e qarte se cila do te jete nxitja ekonomike e operatoreve te marrin pjese ne procesin e tenderit publik. Ka me teper mundesi qe operatoret nuk do te merrnin riskun per te ndermarre detyrime te sherbimit universal pa patur sigurine se kostot e ofrimit te ketij sherbimi nuk do t'i vendosnin ne nje pozite te pafavorshme ne krahasim me operatoret e tjere.

Per keto arsye, Vodafone Albania eshte e mendimit se financimi i jashtem nepermjet fondit te sherbimit universal duhet te jepet vetem nese AKEP vendos se kostot neto per ofrimin e sherbimit universal perbejne nje barre te padrejte konkurruese per OSHU.

Meqenese Plani Kuader do te pergatitet nga AKEP per nje periudhe tre vjecare, caktimi i OSHU duhet te parashikohet per te njejten periudhe kohore dhe rivleresuar pas kesaj periudhe.

19. Ju lutem jepni opinionet tuaja lidhur me kriteret e vendimit, në rast se tenderi dështon dhe AKEP duhet të vendosë midis përfundimit (pezullimit) të procesit të caktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një tender të suksesshëm apo vazhdimin me procesin e nominimit.

Duke marre parasysh mundesine per ta realizuar kete element te detyrimit te SHU nepermjet operatoreve te tregut, Vodafone Albania eshte e mendimit se nese tenderi deshton, AKEP duhet te vendose te perfundoje (pezulloje) procesin e caktimit derisa kushtet te jene me te favorshme per nje tender te suksesshem, ne vend qe te procedoje me procesin e nominimit.

20. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi kriteret e mundshme të caktimit të përfshira para Pyetje 15, të cilat mund të merren parasysh nga AKEP për të përzgjedhur operatorin apo operatorët më të mirë si OSHU për të ofruar elementin në fjalë të Detyrimit të Shërbimit Universal. A ka kritere të tjera që mund të merren parasysh nga AKEP?

Ju lutem referojuni komenteve tona ne Pyetjen 15.

21. Ju lutem jepni opinionet tuaja në lidhje me analizën dhe opsionet e përshkruara më sipër. Ju lutem rendisni opsionet nga më i përshtatshmi tek më pak i përshtatshmi përShqipërinë. Ju lutem përshkruani opsione të tjera (apo variante të opsioneve të përshkruara më sipër) të cilat AKEP duhet t'i marrë parasysh në analizën e tij.

Ulja e perdorimit te telefonave publike me pagese ne BE, por edhe ne Shqiperi kerkon nje rishikim per te vendosur se aktualisht telefonat publike me pagese nuk jane me te pershtatshme duke patur parasysh se kostot e tyre te mirembajtjes i tejkalon perfitimet qe ato sjellin per perdoruesit. Ne zona ku penetrimi celular eshte tashme i larte dhe ne zona ku telefonat publike me pagese mund te ofrohen me nje interes ekonomik, pa patur nevojte per rregullim, nje kerkese per te ndertuar dhe mirembajtur nje sasi te madhe te telefonave publike me pagese nuk eshte e nevojshme per arsye te perfshirjes sociale dhe mund te rrezikojte zhvendosjen e sherbimeve

tregtare. Pra, kostot per te investuar ne ndertimin dhe mirembajtjen e nje sistemi te telefonave publike me pagese nuk justifikohen nga perfitimet qe ky sherbim mund t'i sjelle shoqerise. Ky element i sherbimit universal, me zhvillimin e teknologjive te reja dhe uljen e rendesishme te tarifave te sherbimit celular, eshte i vjeteruar.

Sa me siper, Vodafone Albania sugjeron se opsioni me i pershtatshem per AKEP eshte te percaktoje se elementi i telefonave publike me pagese nuk eshte me i nevojshem/i aplikueshem duke marre parasysh mbulimin dhe penetrimin celular.

Ne rast se AKEP nuk do te pranonte sugjerimin tone, duhet te zgjedhe Opsionin 12, te monitoroje situaten deri me 31 Dhjetor 2015. Vodafone Albania e kundershkon me force caktimin e nje OSHU per elementin e telefonave publike me pagese.

22. Ju lutem jepni sugjerimet tuaja lidhur me llojet apo natyrën e reformave rregullatore apo reforma të tjera që mund të përdoren për promovimin e telefonave publikë me pagesë në Shqipëri.

Kjo pyetje nuk aplikohet. Vodafone Albania eshte e mendimit se asnje mase rregullatore apo reforma nuk jane te nevojshme per te promovuar telefonat publike me pagese ne Shqiperi, duke marre parasysh daljen e tyre nga perdorimi.

23. Ju lutem jepni komentet tuaja në lidhje me çdo proces tenderi publik për caktimin e Ofruesit të Shërbimit Universal që do të implementojë këtë element të detyrimit të SHU. Në mënyrë të veçantë, ju lutem komentoni mbi llojet e termave dhe kushteve të tilla që Ofruesi i Shërbimit Universal të mos ketë nevojë apo kërkojë asnjë financim të jashtëm. Gjthashtu ju lutem jepni komentet tuaja mbi periudhën e kohëzgjatjes së caktimit të OSHU.

Ne rast se AKEP vendose te caktoje nje OSHU per ofrimin e elementit te telefonave publike me pagese, Vodafone Albania mbeshtet procesin e nje tenderi publik, si nje proces i drejtuar nga konkurrueshmeria ndermjet paleve te interesuara.

Nga eksperiencia ne vendet e tjera, financimi i jashtem kerkohet rrallehere nga OSHU, pasi autoritetet rregullatore kane vleresuar se perfitimet qe realizohen nga OSHU nepermjet ofrimit te sherbimit universal i tejkalon kostot qe OSHU ka per keto sherbime, ose qe keto kosto nuk perbejne nje barre te padrejte per OSHU.

Megjithate, meqenese ne Shqiperi nuk ka eksperience per implementimin e detyrimit te sherbimit universal, nuk eshte e qarte se cila do te jete nxitja ekonomike e operatoreve te marrin pjese ne procesin e tenderit publik. Ka me teper mundesi qe operatoret nuk do te merrnin riskun per te ndermarre detyrime te sherbimit universal pa patur sigurine se kostot e ofrimit te ketij sherbimi nuk do t'i vendosnin ne nje pozite te pafavorshme ne krahasim me operatoret e tjere.

Per keto arsye, Vodafone Albania eshte e mendimit se financimi i jashtem nepermjet fondit te sherbimit universal duhet te jepet vetem nese AKEP vendos se kostot neto per ofrimin e sherbimit universal perbejne nje barre te padrejte konkurruese per OSHU.

Ne llogaritjen e kostove neto, AKEP duhet te marre parasysh perfitimet e patrupezuara qe OSHU do te kishte ne mbajtjen e monopolit te sherbimeve te telefonave publike me pagese, perfitime te gjera marketingu ne te gjithë vendin dhe nga arritja e asaj pjese te tregut e cila nuk do te ishte arritur ndryshe.

Meqenese Plani Kuader do te pergatitet nga AKEP per nje periudhe tre vjecare, caktimi i OSHU duhet te parashikohet per te njejten periudhe kohore dhe rivleresuar pas kesaj periudhe.

- 24. Ju lutem jepni opinionet tuaja lidhur me kriteret e vendimit, në rast se tenderi dështon dhe AKEP duhet të vendosë midis përfundimit (pezullimit) të procesit të përcaktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një tender të suksesshëm dhe vazhdimin me procesin e nominimit.**

Duke marre parasysh kostot e larta qe do te merreshin persiper nga operatori i cakutar ne rast te ndertimit dhe mirembajtjes se telefonave publike me pagese, Vodafone Albania eshte e mendimit se nese tenderi deshton, AKEP duhet te vendose te perfundoje procesin e caktimit derisa kushtet te jene me te favorshme per nje tender te suksesshem, ne vend qe te procedoje me procesin e nominimit.

- 25. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi kriteret për caktimin e Ofruesit të dhëna mbi Pyetjen 15, të cilat mund të merren parasysh nga AKEP për të vendosur se cili operator apo cilët operatorë janë të vendosur më mirë si OSHU për të ofruar elementin në fjalë të detyrimit të SHU. A ka kritere të tjera që duhet të merren parasysh nga AKEP?**

Ju lutem referojuni komenteve tona ne Pyetjen 15.

- 26. Ju lutem jepni opinionet tuaja në lidhje me analizën dhe opsionet e përshkruara më sipër. Ju lutem rendisni opsionet nga më i përshtatshmi tek më pak i përshtatshmi për Shqipërinë. Ju lutem përshkruani opsione të tjera (apo variante të opsioneve të përshkruara më sipër) të cilat AKEP duhet t'i marrë parasysh në analizën e tij. Nëse preferohet Opsioni #13, ju lutem komentoni mbi shërbimet apo lehtësirat specifike që duhet përfshirë në këtë përcaktim.**

Duke ndjekur parimin se komunikimi nuk është luks, por domosdoshmëri, Vodafone ka ndërmarrë iniciativa për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit nëpërmjet prokurimeve të aparate të posaçme dhe duke ofruar shërbime të përshtatura për nevojat e tyre. Në kuadër të këtyre iniciativave, Vodafone Albania ka hedhur në treg sa me poshte:

- Celularin Vodafone 155 me një çmim të aresyeshem prej 4,400 lekë (me TVSH), ose afërsisht 32 Euro, te pergatitur posaçërisht për te moshuarit, personat që përdorin shërbimet telefonike baze - telefonata dhe SMS. Celulari ka një tastierë të madhe me butona të mëdha dhe numra të dukshem dhe një ekran me ngjyra e kontrast të lartë. Celulari ka një veçori: një buton te madh në formë zemre ne pjesen e pasme të telefonit, e cila mundëson kryerjen e (telefonatave) te emergjencës (SOS) dhe dergimin e SMS-ve drejt 5 numrave njëkohësisht.

Per t'i ardhur ne ndihme perdoruesve në momente te tjera emergjence, celulari është i pajisur me një ndricues të vogël. Ai ka gjithashtu radio e cila nuk ka nevojë per antenë ose kufje.

Celulari ka një bateri të fuqishme, qe i pergjigjet nevojave aplikacioneve te tij.

- Më poshtë është përshkrimi i shërbimit "VF Club për komunitetin e personave me degjim te kufizuar"

Qe nga 24 Tetori i 2011, Vodafone Albania ka vënë në dispozicion një ofertë të veçantë të dedikuar për komunitetin e personave me aftësi të kufizuara ne degjim në Shqipëri.

Kjo ofertë i jep këtij grupi klientësh mundësinë për të aktivizuar falas një ofertë ku ata paguajnë vetëm minuten e parë te thirrjes per Video call, SMS dhe MMS qe kryejne/dergojne gjate dites (duke filluar nga ora 00:00) dhe të komunikojnë gjate pjesës tjetër të ditës (deri 23 : 59) falas (për Video Call, SMS dhe MMS) për 12 muaj.

Kohezgjatja minimale e tarifuar per thirrjen e parë, pas regjistrimit në promo, do të jetë 60 sekonda (24 Lekë me TVSH drejt Vodafone Club). Nuk do të ketë pagesë shtesë për konsumatorin, nëse thirrja e parë zgjat më shumë se 60 sekonda, pasi nuk do të ketë pagesë shtesë për thirrjet e njëpasnjëshme gjate ditës, deri në minutin e 200te te Closed User Group (CUG).

Pas SMS ose MMS te pare te Closed User Group (CUG) (5.88 lekë me TVSH) të ditës, nuk do të ketë pagesë shtesë për çdo SMS apo MMS CUG vijuese brenda ditës deri në 200 SMS ose MMS. - SMS dhe MMS do të zbriten nga i njeiti grup i 200 njësive / ditë.

Çdo Video call CUG ose dergimin CUG SMS / MMS mbi limitet e përdorimit sipas Politikës se Përdorimit te Drejte do të tarifohen në bazë të tarifave nominale VF Club.

Per pjesetaret e komunitetit te personave me aftësi te kufizuara ne degjim, me paraqitjen e nje certificate mjekesore nga ana e tyre, ofrohen cmime te ulura te aparateve celulare:

Modeli	Sasia	Cmimi i pakices	Cmimi i ulur	Ulja	Afersisht ne Euro
LG KU950	97	14200	12000	-15%	88.00
Nokia N97 Mini	18	59400	31000	-48%	227.00
Nokia N79	15	43800	21000	-52%	154.00
Nokia 5610	15	27900	13000	-53%	95.00
Nokia 5320	15	25500	15000	-41%	110.00
Sharp 880	10	33000	15000	-55%	110.00

Per kete arsye, Vodafone Albania mendon se tregu eshte ne gjendje te plotesoje nevojat e perdoruesve me ane te mekanizmit te konkurrences se lire dhe Opsioni 14 eshte me i pershtatshmi per Shqiperine, ndersa Opsioni 13 eshte me pak i pershtatshem.

Ne vend te caktimit te nje OSHU, qeveria mund te ofroje nxitje per lojtaret e tregut per te gjetur zgjidhje te metejshme te reja per grupe te ndryshme te perdoruesve me aftësi te kufizuara, permes masave te pershkrura ne pyetjen 27 me poshte.

27. Ju lutem jepni sugjerimet tuaja lidhur me llojet apo natyrën e reformave rregullatore apo reforma të tjera që mund të përdoren për promovimin e masave ekuivalente për përdoruesit me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Vodafone Albania propozon për AKEP dhe qeverinë rolet e mëposhtme në lidhje me aksesibilitetin në lidhje me shërbimet e komunikimit elektronik:

- a) Te edukojë përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara në përdorimin e teknologjive të reja;
- b) Te ofrojë financim për zhvillimin e software-ve dhe aplikimeve;
- c) Te lehtësojë shpërndarjen e Smartphones pranë përdoruesve me aftësi të kufizuara;
- d) Te marrë masa rregullatore (si p.sh. ritransmetues me tekst (text relay), shërbime emergjence, mundësia për të parë faturat);
- e) Te detyrojë masa aksesibiliteti për shërbimet kryesore publike, shërbimet shtetërore;
- f) Te vazhdojë të mbështetë zhvillimin e broadband-it celular dhe fiks.

Për sa i përket operatorëve të komunikimeve elektronike, ata do të vazhdojnë të analizojnë nevojat e përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara dhe të konkurrojnë nepermjet inovimit. Taksa shtetërore dhe masa nxitëse financiare mund t'u ofrohen operatorëve që sjellin zgjidhjet më inovative në lidhje me pajisje fundorë të përshtatshme. AKEP mund të detyrojë SMS pa tarifim drejt numrave të urgjencës (për ata përdorues që nuk mund të komunikojnë nepermjet zerit).

28. Ju lutem jepni komentet tuaja në lidhje me çdo proces tenderi publik për caktimin e Ofruesit të Shërbimit Universal që do të implementojë këtë element të detyrimit të SHU. Në mënyrë të veçantë, ju lutem komentoni mbi llojet e termave dhe kushteve të tilla që Ofruesi i Shërbimit Universal të mos ketë nevojë apo kërkojë asnjë financim të jashtëm.

Sipas ndryshimeve të Ligjit 9918, procesi i tenderit publik është zëvendësuar me një procedurë të re. Kjo procedurë për caktimin e OSHU parashikon se detyrimi i SHU do të caktohet nga AKEP duke u bazuar në rregullat e parashikuara në një vendim të Këshillit të Ministrave të leshuar për këto qëllime.

Në rast se AKEP vendos të caktojë një OSHU për implementimin e elementit të masave ekuivalente për përdoruesit me aftësi të kufizuara, Vodafone Albania mbështet procesin e tenderit publik, si një proces i drejtuar nga konkurrueshmëria ndërmjet paleve të interesuara.

Nga eksperiencat në vendet e tjera, financimi i jashtëm kërkohet rrallëherë nga OSHU, pasi autoritetet rregullatore kanë vlerësuar se përfitimet që realizohen nga OSHU nepermjet ofrimit të shërbimit universal i tejkalon kostot që OSHU ka për këto shërbime, ose që këto kostot nuk përbejnë një barrë të padrejte për OSHU.

Megjithatë, meqenëse në Shqipëri nuk ka eksperiencë për implementimin e detyrimit të shërbimit universal, nuk është e qartë se cilat do të jenë shtysat ekonomike të operatorëve të marrin pjesë në procesin e tenderit publik. Ka më tepër mundësi që operatorët nuk do të marrin riskun për të ndërmarrë detyrime të shërbimit universal pa patur sigurinë se kostot e ofrimit të këtij shërbimi nuk do t'i vendosnin në një pozitive të pafavorshme në krahasim me operatorët e tjerë.

Per keto arsye, Vodafone Albania eshte e mendimit se financimi i jashtem nepermjet fondit te sherbimit universal duhet te jepet vetem nese AKEP vendos se kostot neto per ofrimin e sherbimit universal perbejne nje barre te padrejte konkurruese per OSHU.

Ne llogaritjen e kostove neto, AKEP duhet te marre parasysh perfitimet e patrupezuara qe OSHU do te kishte duke patur monopolin e sherbimit per personat me aftesi te kufizuara, perfitime te gjera marketingu ne te gjitha vendin dhe duke arritur ate pjese te tregut qe nuk do te mund te arrihej ndryshe.

Meqenese Plani Kuader do te pergatitet nga AKEP per nje periudhe tre vjecare, caktimi i OSHU duhet te parashikohet per te njejten periudhe kohore dhe rivleresuar pas kesaj periudhe.

29. Ju lutem jepni opinionet tuaja lidhur me kriteret e vendimit, në rast se tenderi dështon dhe AKEP duhet të vendosë midis përfundimit (pezullimit) të procesit të caktimit derisa kushtet të jenë më të favorshme për një tender të suksesshëm dhe vazhdimin me procesin e nominimit.

Duke marre parasysh mundesine per ta realizuar kete element te detyrimit te SHU nepermjet operatoreve te tregut, Vodafone Albania eshte e mendimit se nese tenderi deshton, AKEP duhet te vendose te perfundoje (pezulloje) procesin e caktimit derisa kushtet te jene me te favorshme per nje tender te suksesshem, ne vend qe te procedoje me procesin e nominimit.

30. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi kriteret për caktimin e Ofruesit, të dhëna para Pyetjes 15, të cilat mund të merren parasysh nga AKEP për të vendosur cili operator apo cilët operatorë janë të vendosur më mirë si OSHU për të ofruar elementin në fjalë të detyrimit të SHU. A ka kritere të tjera që mund të merren parasysh nga AKEP?

Ju lutem referojuni komenteve tona ne Pyetjen 15.

31. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi implementimin e tarifës apo dispozitave të tjera të Nenit 27 të Ligjit 9918, përfshirë amendimet përkatëse të propozuara nga Qeveria e Shqipërisë.

Vodafone Albania shprehet dakord me dispozitat e Nenit 27 te Ligjit 9918 dhe rregullimit te tarifave te sherbimit universal te ofruara nga OSHU ne perputhje me Direktiven e Sherbimit Universal.

32. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi implementimin e cilësisë së shërbimit apo dispozitave të tjera të Nenit 28 të Ligjit 9918.

AKEP duhet te percaktoje standartet minimale per cilesine e sherbimit per sherbimin universal ne Rregulloren per implementimin e detyrimeve te sherbimit universal. Vodafone Albania sugjeron se ne varesi te elementeve te detyrimeve te SHU qe do te percaktohen, indikatorret e cilesise se sherbimit te parashikuar ne Aneksin III te Direktives per Sherbimin Universal duhet te publikohen nga ofruesi i sherbimit universal, si me poshte vijon:

- Koha e furnizimit per lidhjen fillestare;

- Norma i gabimeve per cdo linje akses;
- Koha e riparimit te gabimit;
- Raporti thirrjeve te pasuksesshme;
- Koha e vendosjes se thirrjes;
- Kohet e pergjigjes per sherbimet e operatorit;
- Kohet e pergjigjes per sherbimet e kerkimit ne numerator;
- Proporcioni i telefonave publike me pagese me monedha dhe me karta ne gjendje pune;
- Ankesat per korrektesine e faturimit.

33. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi implementimin e skemës së kompensimit dhe dispozitat e tjera në Nenin 29 të Ligjit 9918, përfshirë amendimet përkatëse të propozuara nga Qeveria e Shqipërisë.

Vodafone Albania eshte dakord me dispozitat e Nenit 29 te Ligjit 9918 per skemen e kompensimit. Sic parashikohet ne Paragrafin 9, AKEP do te percaktoje kompensimin e kostove neto, vetem pas llogaritjeve te tyre, duke marre ne konsiderate perfitimet e patrupezuara te OSHU ne ofrimin e ketyre sherbimeve.

Ne kete aspekt, AKEP duhet te percaktoje menyren sesi kostot neto do te llogariten dhe te specifikoje perfitimet e jotrupezuara qe do te merren ne konsiderate. Disa nga keto perfitime qe jane marre parasysh ne vende te tjera, jane perfshire ne komentet tona ne Pyetjen 3.

Vetem pasi te jete percaktuar se ka nje barre te padrejte per OSHU, AKEP mund te kerkoje kontributin financiar ne fondin e sherbimit universal nga operatoret e tjere te komunikimeve elektronike.

34. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi implementimin e regjimit të financimit si dhe dispozitat e tjera në Nenin 30 të Ligjit 9918.

Financimi i sherbimit universal duhet te parashikohet vetem pasi te jene vendosur dhe konfirmuar nga AKEP kostot neto te deklaruar nga ofruesi(t) i sherbimit universal per ofrimin e sherbimit universal. Vetem pas konfirmimit nga ana e AKEP te ketyre kostove neto, mundet AKEP te vendose per kuoten e financimit dhe operatoret e tjere te komunikimeve elektronike te detyrohen te kontribuojne ne fondin e sherbimit universal te menaxhuar nga AKEP.

Vodafone Albania sugjeron se rregullorja e AKEP per implementimin e regjimit te financimit duhet te parashikoje se kontributet ne fondin e sherimit universal duhet te llogariten ne proporcion me kostot neto te konfirmuara nga AKEP, te ndara ne menyre te barabarte ndermjet operatorëve te komunikimeve elektronike ne treg, gjithsesi duke mos tejkaluar 1% te te ardhurave te sektorit.

35. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi çështje të tjera që nuk janë përfshirë në këtë Kapitull dhe të cilat duhet të merren parasysh nga AKEP-i në analizën e tij.

Vodafone Albania nuk ka ceshje te tjera per te sjelle ne vemendjen tuaj.

36. Ju lutem jepni opinionet tuaja mbi hapat e mëtejshme të propozuara në këtë seksion. Propozoni hapa apo veprime të tjera në këtë drejtim të cilat duhet të merren në konsideratë nga AKEP.

Vodafone Albania është dakord me hapat e mëtejshme të propozuar në këtë seksion dhe inkurajon AKEP-in të konsultohet me palët e interesuara në çdo hap të hartimit të Planit Kuader, rregulloreve për detyrimin e SHU, si dhe çdo dokument tjetër që do të hartohet në të ardhmen.

Vodafone Albania do të vlerësojë nëse palët e interesuara do t'u jepej me shumë informacion për afatet kohore për hartimin e kuadrit rregullator dhe implementimit të Detyrimit të SHU në mënyrë që të garantohen parashikueshmëria dhe siguria ligjore.